



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo

Agjencia kundër Korrupsionit
Agencija protiv Korupcije / Anti-corruption Agency

RAPORT

**RASTET E INICIUARA PËR MOS DEKLARIM
TË PASURISË DHE SANKSIONET**

Permbajtja:

Hyrje	2
Inicimi I Procedurave Kundërvajtëse Gjatë Vitit 2010.....	4
Inicimi I Procedurave Kundërvajtëse Gjatë Vitit 2011.....	8

Hyrje

Agjencia kundër Korrupsionit (AKK) është institucion i pavarur dhe themelorë në luftimin dhe parandalimin e Korrupsionit në Kosovë. Baza ligjore për funksionimin e Agjencisë është Ligji Për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe Ligji për Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar.

Mandati i Agjencisë është i përqendruar në zbulimin dhe hetimin e rasteve korruptive, përpjekjeve për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit si dhe sensibilizimin e opinionit publik me qëllim të ndërtimit të një shoqërie të shëndoshë që bazohet në shtetin e së drejtës.

Gjatë vitit 2011 gjegjësisht më 31 gusht, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë. Gjithashtu edhe me këtë ligj janë paraparë sanksione, apo veprime kundërvajtëse për zyrtarët e lartë publik që nuk deklarojnë pasurinë brenda afateve ligjore, mirëpo janë rritë shumat për secilin sanksion dhe është përcaktuar edhe një masë e ku krahas dënimeve me gjobë mund të shqiptohen edhe masat për mbrojtje si: Ndalimi i ushtrimit të funksionit deri në një (1) vit.

Për më tej, Neni 17 i Ligjit nr. 04/L-050 i parasheh sanksionet si në vijim:

Kushdo që shkelë detyrimet e përcaktuara me këtë ligj, që nuk janë vepra penale, zyrtari i lartë publik bënë kundërvajtje dhe dënohet si:

- Zyrtarët e lartë publik për mos deklarim të rregullt vjetor të pasurisë dënohet me gjobë prej njëmijë (1000) deri dymijë e pesëqind (2500) Euro;
- Zyrtarët e lartë publik për mos deklarim të pasurisë me rastin e marrjes së detyrës dënohet me gjobë prej njëmijë (1000) deri dymijë e pesëqind (2500) Euro;
- Zyrtarët e lartë publikë për mos deklarim të pasurisë sipas kërkesës e Agjencisë dënohet me gjobë prej njëmijë e pesëqind (1500) deri dymijë e pesëqind (2500) Euro;
- Zyrtarët e lartë publikë për mos deklarim të pasurisë pas largimit nga funksioni dënohet me gjobë prej njëmijë (1000) deri në dymijë e pesëqind (2500) Euro;
- Subjekti që sipas kërkesës së Agjencisë nuk vepron në pajtim me paragrafin 3. të nenit 15 të këtij ligji dënohet me gjobë prej njëmijë (1000) deri në dymijë e pesëqind (2500) Euro, dënohet për kundërvajtje

Për iniciimin e procedurës për kundërvajtje, Agjencia e njofton udhëheqësin ose institucionin në të cilin zyrtari i lartë publik punon ose ka punuar,

Agjencia publikon emrat e zyrtarëve të lartë publik të cilët nuk e kanë dorëzuar formularin mbi gjendjen e pasurisë, ashtu siç është paraparë në këtë ligj.

Nëse shkelja e detyrimeve të përcaktuara nga ky ligj përbën vepër penale, Agjencia ushtron kallëzim penal. Agjencia kundër Korrupsionit po ashtu do të paraqes ankesë brenda afatit ligjor për të gjitha rastet që është shqiptuar dënimet nga Gjykatat për Kundërvajtje dhe që janë në kundërshtim me Ligjin nr. 03/L-151 dhe Ligjit nr. 04/L-050.

AKK në baza periodike është duke bërë publikime të ndryshme të analizave dhe raporteve mbi nivelin e korrupsionit në Kosovë, përpjekjet për ndjekjen e veprave penale korruptive.

Në këtë analizë do të pasqyrohen të dhëna të sakta statistikore lidhur me rastet të cilat Agjencia kundër Korrupsionit ka iniciuar ndaj zyrtarëve të lartë publik për mos deklarim të pasurisë në pajtim me Ligjin nr. 03/L-151. Ky ligj e sanksionon mos deklarimin e pasurisë si veprim kundër ligjor apo veprim kundërvajtës.

Në vijim do të pasqyrohet rastet e iniciuara ndaj zyrtarëve të lartë publik në Gjykatat kompetente për Kundërvajtje për vitet 2010 dhe 2011 dhe trajtimin e tyre nga ana e tyre.

INICIMI I PROCEDURAVE KUNDËRVAJTËSE GJATË VITIT 2010

Në muajin shkurt të vitin 2010 Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin nr. 03/L-151 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik. Me këtë ligj janë paraparë edhe disa sanksione, apo veprime kundërvajtëse për zyrtarët e lartë publik që nuk deklarojnë pasurinë brenda afateve ligjore.

Neni 16 i Ligjit nr. 03/L-151 i parasheh sanksionet si në vijim:

Për shkelje të detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, që nuk janë vepra penale, zyrtari i lartë publik bën kundërvajtje dhe dënohet me gjobë:

- Zyrtarët e lartë publik për mos deklarimin e rregullt vjetor të pasurisë dënohen me gjobë prej treqind (300) deri një mijë (1000) Euro;
- Zyrtarët e lartë publik për mos deklarimin e pasurisë me rastin e marrjes së detyrës dënohen me gjobë prej njëqindpesëdhjetë (150) deri në pesëqind (500) Euro;
- Zyrtarët e lartë publik për mos deklarimin e pasurisë sipas kërkesës së Agjencisë dënohen me gjobë prej pesëqind (500) deri njëmijepesëqind (1500);
- Zyrtarët e lartë publikë për mos deklarimin e pasurisë pas largimit nga funksioni dënohen me gjobë prej njëqindpesëdhjetë (150) deri në pesëqind (500) Euro;
- Subjekti që sipas kërkesës së Agjencisë nuk vepron në pajtim me paragrafin 3 të nenit 14 të këtij ligji dënohet me gjobë prej njëqindpesëdhjetë (150) deri në pesëqind (500) Euro;

Për iniciimin e procedurës kundërvajtëse, Agjencia e njofton udhëheqësin ose institucionin në të cilin zyrtari i lartë punon ose ka punuar.

Po ashtu Agjencia publikon emrat e zyrtarëve të lartë publik të cilët nuk e kanë dorëzuar formularin për deklarim, ashtu siç është e paraparë në këtë ligj.

Agjencia kundër Korrupsionit ka iniciuar procedurën kundërvajtëse në Gjykatat kompetente ndaj të gjithë zyrtarëve të lartë publikë që nuk kanë përmbushur obligimin ligjor për deklarimin e pasurisë në pajtim me nenin 5 të Ligjit nr. 03/L-151.

Gjendja e përgjithshme e zyrtarëve të lartë publik që kanë pasur për obligim deklarimin e pasurisë, dhe numri i zyrtarëve të lartë publik që nuk kanë përmbushur këtë obligim ligjor.

Institucionet	Numri i zyrtarëve të lartë publik që kanë për obligim deklarimin e pasurisë	Kanë deklaruar pasurinë	Nuk kanë deklaruar pasurinë
Presidenca	06	06	00
Kuvendi	124	123	01
Qeveria	720	670	50
Gjykatat	284	283	01
Institucionet e Pavarura	156	152	04
Komunat	130	121	09
Ndërmarrjet Publike	140	128	12
TOTALI	1560	1483	77

Tabela 1: Deklarimi i pasurisë 2010

Nga numri i përgjithshëm i zyrtarëve të lartë publik që kanë pasur për obligim deklarimin e pasurisë, **1483** zyrtar të lartë publik kanë përmbushur obligimin ligjor, ndërsa **77** zyrtar të lartë publik nuk kanë respektuar Ligjin nr. 03/L-151. Ndaj të gjithë zyrtarëve të lartë publik që nuk kanë deklaruar pasurinë, AKK-ja ka iniciuara procedurën kundërvajtëse në Gjykata kompetente për Kundërvajtje.

Në vijim do të paraqesim listën e zyrtarëve të lartë publik ndaj të cilëve është iniciuar procedura kundërvajtëse.

Nr.	Emri	Mbiemri	Institucioni	Gjykata për Kundërvajtje	Aktvendimet, shkalla e parë	Aktvendimet, shkalla e dytë	Ankesat
1.	Slaviša	Petkovič	Kuvendi	Prishtinë	Pezullohet		
2.	Astrit	Salihu	ZKM	Prishtinë	300 Euro		
3.	Zejnullah	Gruda	ZKM	Prishtinë	300 Euro		
4.	Ilirjana	Zymberaj	ZKM - AUV	Prishtinë	800 Euro	300 Euro	
5.	Hysni	Veseli	MAP - IKAP	Prishtinë	300 Euro	300 Euro	
6.	Nuri	Bexheti	MASHT	Prishtinë	1000 Euro		
7.	Adnan	Dragaj	MASHT	Prishtinë	900 Euro		
8.	Alush	Istogu	MASHT	Prishtinë	300 Euro		
9.	Vebi	Ismaili	MASHT	Prishtinë	1000 Euro		
10.	Basri	Muja	MASHT	Prishtinë	300 Euro		
11.	Teuta	Danuza	MASHT	Prishtinë	1000 Euro		
12.	Osman	Gashi	UP	Prishtinë	800 Euro	300 Euro	
13.	Mehdi	Polosi	UP	Prishtinë	1000 Euro	300 Euro	
14.	Lindita	Rugova	UP	Prishtinë	Pezullohet		
15.	Vagjid	Sadriu	UP	Prishtinë	1000 Euro	300 Euro	
16.	Myzafere	Limani	UP	Prishtinë	800 Euro		
17.	Vjosa	Komoni	UP	Prishtinë	Pezullohet		
18.	Enver	Hamiti	UP	Prishtinë	1000 Euro		
19.	Haqif	Mulliqi	UP	Prishtinë	Pezullohet		
20.	Hazer	Dana	MMPH	Prishtinë	800 Euro	300 Euro	
21.	Valon	Krasniqi	MPB	Prishtinë	Pezullohet		
22.	Rafet	Rama	MPB	Prishtinë	300 Euro		
23.	Vilson	Mirdita	MPJ	Prishtinë	Pezullohet		
24.	Imer	Berisha	MPJ	Prishtinë	1000 Euro	Pezullohet	
25.	Islam	Spahiu	MPJ	Prishtinë	800 Euro		
26.	Fatmire	Musliu	MPJ	Prishtinë	300 Euro		
27.	Argjent	Shala	MPJ	Prishtinë	200 Euro		
28.	Arta	Rama	MPJ	Prishtinë	300 Euro		
29.	Milazim	Vllasaliu	MPJ	Prishtinë	1000 Euro	Hudhet poshtë	
30.	Musa	Vitija	MSH	Prishtinë	800 Euro		
31.	Mazllum	Belegu	MSH	Prishtinë	300 Euro		
32.	Miradije	Mavriqi	KQZ	Prishtinë	1000 Euro	Qortim	
33.	Miradije	Meha	KQZ	Prishtinë	300 Euro	300 Euro	
34.	Lulzim	Kurtaj	ART	Prishtinë	900 Euro		
35.	Engin	Beyoglu	K. Prishtinë	Prishtinë	300 Euro		
36.	Shemsi	Syla	RTK	Prishtinë	1000 Euro		
37.	Naime	Beqiraj	RTK	Prishtinë	1000 Euro		
38.	Isak	Rakovica	KMDK	Prishtinë	1000 Euro	500 Euro	

39.	Makfire	Osmani	KMDK	Prishtinë	Pezullohet		
40.	Fadil	Rrustemi	KOSTT	Prishtinë	Pezullohet		
41.	Gyltene	Sylejmani	Gjykata S.K.	Prishtinë	150 €uro	Pezullohet	03.08.12
42.	Artan	Ibrahimi	MASHT	Prishtinë	Pezullohet		
43.	Flutura	Hoxha	MAPL	Prishtinë	200 €uro	Pezullohet	03.08/12
44.	Lulzim	Pllana	MASHT	Prishtinë	Pezullohet		
45.	Liridon	Restelica	MEM	Prishtinë	200 €uro		
46.	Sara	Rexhepi	MEM	Prishtinë	500 €uro		
47.	Sabit	Gashi	MEM	Prishtinë	Pezullohet		
48.	Ramadan	Gagica	MEM	Prishtinë	200 €uro		
49.	Emilija	Redjepi	MEM	Prishtinë	300 €uro		
50.	Hamit	Qeriqi	MAP - IKAP	Prishtinë	-----	-----	
51.	Sanije	B. Hysaj	MPJ	Prishtinë	-----	-----	
52.	Gazmend	Rushiti	MSH	Prishtinë	-----	-----	
53.	Hysni	Bajrami	KQZ	Prishtinë	-----	-----	
54.	Isak	Jashari	UP	Ferizaj	300 €uro		
55.	Binaze	Jashari	UP	Ferizaj	300 €uro		
56.	Xheladin	Zymeraj	UP	Prizren	Pezullohet		
57.	Sadik	Paqarizi	KRM.Prizren	Prizren	Pezullohet		
58.	Bashkim	Krasniqi	KRM.Prizren	Prizren	Pezullohet		
59.	Nijazi	Kryeziu	K. Prizren	Prizren	-----	-----	
60.	Xhelal	Canziba	KRM. Prizren	Prizren	-----	-----	
61.	Tafil	Krasniqi	KRM. Prizren	Prizren	-----	-----	
62.	Shpejtim	Skivjani	MSH	Gjakovë	300 €uro		
63.	Bislim	Hoti	K. Gjakovë	Gjakovë	300 €uro		
64.	Mazllum	Kumnova	UP	Gjakovë	-----	-----	
65.	Luan	Gola	MSH	Gjakovë	-----	-----	
66.	Mark	Komani	K. Gjakovë	Gjakovë	-----	-----	
67.	Sami	Cacaj	K. Deçan	Deçan	-----	-----	
68.	Jashar	Dobraj	K. Deçan	Deçan	-----	-----	
69.	Bashkim	Ramosaj	K. Deçan	Deçan	-----	-----	
70.	Ukshin	Rrecaj	KRM. Uniteti	Mitrovicë	-----	-----	
71.	Fehmi	Mehmeti	KRM. Uniteti	Mitrovicë	-----	-----	
72.	Naxhije	Xhemajli	KRM. Uniteti	Mitrovicë	-----	-----	
73.	Zejnije	Kela	Prokuroria	Mitrovicë	-----	-----	
74.	Bahtjar	Kryeziu	UP	Gjilan	Pezullohet		
75.	Husnija	Bibulica	UP	Pejë	Pezullohet		
76.	Bali	Muharremaj	K. Suharekë	Suharekë	300 €uro		
77.	Vesel	Maliqaj	K. Suharekë	Suharekë	300 €uro		
Totali					25,450.00 €	2,600.00 €	

Tabela 2: Lista me emrat e zyrtarëve të lartë publik që nuk kanë deklaruar pasurinë dhe dënimet e shqiptuara nga Gjykatat ndaj tyre;

Shuma e përgjithshme e dënimeve të shqiptuara nga Gjykatat në shkallën e parë është: **25,450.00 €uro**, ndërsa në shkallën e dytë është: **2,600.00 €uro**.

Në vijimi do të paraqesim pasqyrën e përgjithshme lidhur me rastet e iniciuar, dhe informacionet e trajtuara nga gjykatat.

Gjykata	Raste të paraqitura	Të trajtuara		Pa informacione	
Prishtinë	53	49	92%	04	08%
Prizren	06	03	50%	03	50%
Gjakovë	05	02	40%	03	60%
Mitrovicë	04	00	00%	04	100%
Deçan	03	00	00%	03	100%
Ferizaj	02	02	100%	00	00%
Suharekë	02	02	100%	00	00%
Pejë	01	01	100%	00	00%
Gjilan	01	01	100%	00	00%
Totali	77	60	78%	17	22%

Tabela 03: Rastet e paraqitura nga AKK dhe trajtimi i tyre nga Gjykatat

Duke u bazuar në aktvendimet e pranuar nga Gjykatat për rastet e iniciuara në vitin 2010, mund të shihet se nga numri i përgjithshëm i rasteve të iniciuara ndaj 77 zyrtarëve të lartë publik, 60 prej tyre apo 78% e rasteve kanë vendosur Gjykatat, ndërsa në 17 raste apo 22% nuk kemi pranuar informacione lidhur me fatin e tyre.

Nga nëntë (9) Gjykata për Kundërvajtje që kemi iniciuar procedurat kundërvajtëse, katër (4) Gjykata i kanë trajtuar të gjitha rastet, tri (3) Gjykata i kanë trajtuar pjesërisht rastet, ndërsa dy (2) Gjykata tjera nuk kanë trajtuar asnjë rast të paraqitur gjatë vitit 2010.

Sanksionimi i mos deklarimit të pasurisë nga Gjykatat Komunale/ viti 2010

Gjykata për Kundërvajtje në Prishtinë, dëshmon një efikasitet shumë më të mirë krahasuar me punën që kanë bërë gjykatat tjera komunale të Kosovës. Kjo gjykatë i ka trajtuar gati të gjitha lëndët që I janë adresuar asaj, më fjalë tjera rreth 69% të të gjitha rasteve.

Nga 53 lëndë sa AKK-ja I ka adresuar tek GJKP-ja kjo e fundit I ka shqiptuar 40 dënime, I ka pezulluar 10 kurse 3 lëndë nuk I ka trajtuar fare. Nga aktvendimet e shqiptuar del se në 3 raste shqiptimi I gjobave është nën minimumin ligjor (300 euro)

Gjykata për Kundërvajtje në shkallën e dytë është treguar më “humane” ku gati në të gjitha rastet e trajtuara aktvendimet e shkallës së parë I ka ndryshuar duke I zvogëluar të gjitha dënimet. AKK e vlerëson të pajustificueshme zvogëlimi i të gjitha dënimeve të shkallës së parë. Si ilustrim është rasti kur në shkallën e parë gjykata merr vendim për sanksionimin me gjobë prej 1000 eurove, ndërsa shkalla e dytë e gjykatës e pezullon atë në tërsi.

Gjykatat në Ferizaj dhe Suharekë I kanë trajtuar lëndët e dërguara nga AKK-ja për mos deklarimin e pasurisë nga ana e zyrtarëve të lartë publik dhe kanë vendosur për shqiptimin e gjobave minimale, nga 300 euro, në secilën gjykatë nga 4 raste.

Gjykata në Gjakovë nga pesë rastet e dërguara I trajtuar vetëm dy, ndërsa Gjykatat në Prizren, Deçan, Mitrovicë, Gjilan dhe Pejë nuk I kanë trajtuar fare rastet e dërguara për mos deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik për vitin 2010.

INICIMI I PROCEDURAVE KUNDËRVAJTËSE GJATË VITIT 2011

Po ashtu edhe këtij viti Agjencia kundër Korrupsionit ka iniciuar procedurën kundërvajtëse në Gjykatat kompetente ndaj të gjithë zyrtarëve të lartë publikë që nuk kanë përmbushur obligimin ligjor për deklarimin e pasurisë në pajtim me nenin 5 të Ligjit nr. 03/L-151.

Gjendja e përgjithshme e zyrtarëve të lartë publik që kanë pasur për obligim deklaruar pasurisë, dhe numri i zyrtarëve të lartë publik që nuk kanë përmbushur këtë obligim ligjor.

Institucionet	Numri i zyrtarëve të lartë publik që kanë për obligim deklarimin e pasurisë	Kanë deklaruar pasurinë	Nuk kanë deklaruar pasurinë
Presidenca	07	07	00
Kuvendi	124	120	04
Qeveria	871	821	50
Gjykatat	257	255	02
Institucionet e Pavarura	220	215	05
Komunat	158	145	13
Ndërmarrjet Publike	193	179	14
TOTALI	1830	1742	88

Tabela 4: Deklarimi i pasurisë 2011

Nga numri i përgjithshëm i zyrtarëve të lartë publik që kanë pasur për obligim deklarimin e pasurisë, **1742** zyrtar të lartë publik kanë përmbushur obligimin ligjor, ndërsa **88** zyrtar të lartë publik nuk kanë respektuar Ligjin nr. 03/L-151.

Në vijim do të paraqesim listën e zyrtarëve të lartë publik ndaj të cilëve është iniciuar procedura kundërvajtëse.

Nr.	Emri	Mbiemri	Institucioni	Gjykata për Kundërvajtje	Aktvendime t, shkalla e parë	Aktvendime t shkalla e dytë	Ankesat
1.	Avdullah	Isufi	MBPZHR	Prishtinë	400 Euro		
2.	Ahmet	Brahimaj	MKRS	Prishtinë	800 Euro		
3.	Skënder	Boshtrakaj	MKRS	Prishtinë	400 Euro		
4.	Burbuqe	Berisha	MKRS	Prishtinë	200 Euro		
5.	Gani	Mehmetaj	MKRS	Prishtinë	800 Euro	500 Euro	
6.	Blerina	Berisha	MSH-AKPM	Prishtinë	300 Euro		
7.	Qazim	Hysenaj	MSH-QKUK	Prishtinë	Pezullohet		
8.	Ahmet	Brovina	MSH-QKUK	Prishtinë	400 Euro		
9.	Shemsedin	Dreshaj	MSH-QKUK	Prishtinë	450 Euro		
10.	Halit	Ymeri	MSH-QKUK	Prishtinë	800 Euro	800 Euro	
11.	Nexhmi	Hyseni	MSH-QKUK	Prishtinë	2000 Euro		
12.	Nexhat	Krasniqi	MSH-IKSH	Prishtinë	Pezullohet		
13.	Bogoljub	Staletinovic	KQZ	Prishtinë	400 Euro	Pezullohet	
14.	Naser	Shala	ART	Prishtinë	Pezullohet		

15.	Sladjana	Vasic	KNJ	Prishtinë	800 Euro	400 Euro	
16.	Istref	Klinaku	KEK	Prishtinë	Qortim		
17.	Avni	Murati	HK	Prishtinë	Pezullohet		
18.	Ali	Podrimja	RTK	Prishtinë	300 Euro		
19.	Banush	Pacolli	NPBP	Prishtinë	300 Euro		
20.	Sreten	Ivanoviq	K. Novobërdë	Prishtinë	800 Euro	800 Euro	
21.	Murat	Zejnullahu	MSH QKUK	Prishtinë	Qortim		
22.	Sejdi	Rexhepi	BQK	Prishtinë	500 Euro		
23.	Arbnor	Kastrati	MZHE	Prishtinë	600 Euro		
24.	Nadire	Vitija	Termokos	Prishtinë	500 Euro	500 Euro	
25.	Sherafedin	Maxhiu	Termokos	Prishtinë	200 Euro		
26.	Driart	Elshani	MAP	Prishtinë	500 Euro	500 Euro	
27.	Eljana	Naka	MTI	Prishtinë	800 Euro	400 Euro	
28.	Irfan	Lipovica	MTI	Prishtinë	400 Euro		
29.	Granit	Berisha	MTI	Prishtinë	400 Euro		
30.	Valdrin	Uka	MTI	Prishtinë	300 Euro		
31.	Bastri	Musmurati	MAPL	Prishtinë	200 Euro		
32.	Rifat	Krasniqi	MAPL	Prishtinë	200 Euro		
33.	Dragisa	Krstovic	MAPL	Prishtinë	500 Euro		
34.	Komuran	Goranci	MKRS	Prishtinë	Pezullohet		
35.	Emin	Emini	MKRS	Prishtinë	Pezullohet		
36.	Fatos	Berisha	MKRS	Prishtinë	500 Euro		
37.	Emin	Gërbeshi	Kuvendi i K.	Prishtinë	300 Euro		
38.	Kimete	Bytyqi	Kuvendi i K.	Prishtinë	300 Euro		
39.	Ilhami	Gashi	MPB	Prishtinë	200 Euro		
40.	Mimoza	Ahmetaj	ZKM	Prishtinë	200 Euro		
41.	Shpresa	Hasaj-Hyseni	KGJK	Prishtinë	1000 Euro	1000 Euro	
42.	Gëzim	Baxhaku	MZHE	Prishtinë	300 Euro		
43.	Ilmi	Zherka	MASHT-UP	Prishtinë	-----	-----	
44.	Arsim	Ibrahimi	MSH-AKPM	Prishtinë	-----	-----	
45.	Virgjina	Dumnica	KNJ	Prishtinë	-----	-----	
46.	Engin	Behoglu	K Prishtinës	Prishtinë	-----	-----	
47.	Ahmet	Brahimaj	MKRS-DB	Prishtinë	-----	-----	
48.	Ukë	Rugova	Kuvendi	Prishtinë	-----	-----	
49.	Gulsen	Bolukbashi	MPJ	Prishtinë	-----	-----	
50.	Milivoje	Stojanovic	Kuvendi	Prishtinë	-----	-----	
51.	Demë	Abazi	KRM Ambie.	Pejë	-----	-----	
52.	Elez	Hajdari	KUR Hidrodr.	Pejë	-----	-----	
53.	Fehmi	Geci	MBPZHR	Pejë	500 Euro		
54.	Lytfi	Radoniqi	KRM Ambie.	Pejë	Pezullohet		
55.	Dan	Muqkurtaj	KU Drini i B.	Pejë	300 Euro		
56.	Shkodran	Gaxhaferri	KU Drini i B.	Pejë	300 Euro		
57.	Nurishahe	Hulaj	MSH	Prizren	80 Euro		24.07.12

58.	Myzafer	Kalendari	MSH	Prizren	150 €uro		
59.	Sylan	Mazreku	K. Mamushë	Prizren	Pezullohet		
60.	Adem	Bytyqi	MSH	Prizren	Qortim		
61.	Nazmije	Paqarizi	MSH	Prizren	50 €uro		
62.	Lumnije	Hoxha	MSH	Prizren	Qortim		24.07.12
63.	Qazim	Gashi	MSH	Prizren	Qortim		24.07.12
64.	Hatim	Baxhaku	MSH	Prizren	Qortim		31.05.12
65.	Perparim	Krasniqi	KRM Ekoregj	Prizren	500 €uro		
66.	Baki	Hajdari	MSH	Prizren	-----	-----	
67.	Salajdin	Krasniqi	MSH	Prizren	-----	-----	
68.	Adem	Kafexholli	MSH	Prizren	-----	-----	
69.	Ganimete	Sadiku	K. Mamushës	Prizren	-----	-----	
70.	Mensur	Hyseni	MSH	Prizren	-----	-----	
71.	Hasan	Hasani	KRM- Ekoregji.	Prizren	-----	-----	
72.	Rrezarta	Loxha	MKRS	Mitrovicë	-----	-----	
73.	Rukije	Merovci	MSH	Mitrovicë	-----	-----	
74.	Radmila	Kapetanovic	KGJK	Mitrovicë	-----	-----	
75.	Osman	Gojani	MKRS	Gjakovë	-----	-----	
76.	Samile	Pasha	MSH	Gjakovë	-----	-----	
77.	Arsim	Hoxha	MSH	Gjakovë	-----	-----	
78.	Valdet	Salihu	MSH	Gjakovë	-----	-----	
79.	Ramadan	Hasani	K Ferizaj	Ferizaj	300 €uro		
80.	Mehmet	Tahiri	MSH	Ferizaj	300 €uro		
81.	Idriz	Muzaqi	K Vushtrisë	Vushtrri	300 €uro	300 €uro	
82.	Nasip	Sinani	K Klllokot	Viti	150 €uro		
83.	Sabedin	Kadriu	KRM Higjena	Gjilan	300 €uro		
84.	Milan	Stojanovic	K Gjilan	Gjilan	300 €uro	300 €uro	
85.	Omer	Daku	K Gjilan	Gjilan	300 €uro		
86.	Dragisha	Savic	K Kamenicë	Kamenicë	300 €uro		
87.	Ilirjan	Bytyqi	K.Suharekë	Suharekë	400 €uro		
88.	Vesel	Maliqaj	K.Suharekë	Suharekë	1000 €uro		
Totali:					22,580.00 €	5, 500.00 €	

Tabela 5: Lista me emrat e zyrtarëve të lartë publik që nuk kanë deklaruar pasurinë dhe dënimet e shqiptuara nga Gjykatat ndaj tyre.

Shuma e përgjithshme e dënimeve të shqiptuara nga Gjykatat në shkallën e parë është: **22,580.00 €uro**, ndërsa në shkallën e dytë është: **5,500.00 €uro**.

Në vijimi do të paraqesim pasqyrën e përgjithshme lidhur me rastet e iniciuar, dhe trajtimi i rasteve nga gjykatat.

Gjykata	Raste të paraqitura	Të trajtuara		Pa informacione	
Prishtinë	50	42	84%	08	16%
Prizren	15	09	60%	06	40%
Pejë	06	04	67%	02	33%
Gjakovë	04	00	00%	04	100%
Gjilan	03	03	100%	00	00%
Mitrovicë	03	00	00%	03	100%
Ferizaj	02	02	100%	00	00%
Suharekë	02	02	100%	00	00%
Kamenicë	01	01	100%	00	00%
Vushtrri	01	01	100%	00	00%
Viti	01	01	100%	00	00%
Totali	88	65	74%	23	26%

Tabela 6: Rastet e paraqitura nga AKK dhe trajtimi i tyre nga Gjykatat

Duke u bazuar në aktvendimet e pranuar nga Gjykatat për rastet e iniciuara në vitin 2011, mund të shihet, se nga numri i përgjithshëm i rasteve të iniciuara ndaj **88** zyrtarëve të lartë publik, **65** prej tyre apo **74%** e rasteve kanë vendosur Gjykatat, ndërsa në **23** raste apo **26%** nuk kemi pranuar informacione lidhur me fatin e tyre.

Nga njëmbëdhjetë (11) Gjykata për Kundërvajtje që kemi iniciuar procedurat kundërvajtëse, gjashtë (6) Gjykata i kanë trajtuar të gjitha rastet, tri (3) Gjykata i kanë trajtuar pjesërisht rastet, ndërsa dy (2) Gjykata tjera nuk kanë trajtuar asnjë rast të paraqitur gjatë vitit 2011.

Sanksionimi i mos deklarimit të pasurisë nga Gjykatat Komunale/viti 2011

Gjykata për Kundërvajtje në Prishtinë, nga 50 rastet e përcjella (56.81% nga numri i përgjithshëm) ka shpallur aktvendime sanksionuese. në 34 raste, 6 raste I ka pezulluar hetimet në dy raste ka shpallur aktvendime “qortuese” kurse në 8 raste nuk ka vepruar fare. Kjo gjykatë ka dëshmuar një efikasitet shumë më të mirë për sa i përket trajtimit të lëndëve për mos deklarimin e pasurisë nga ana e zyrtarëve të lartë publik, megjithatë në katër raste ka shqiptuar dënime me gjobë më të ulët se sa minimum i caktuar me ligj (300 euro)

Gjykata në Ferizaj i ka pranuar dy raste dhe që të dy vendimet janë marr komfor ligjit në fuqi. Ngjashëm ka funksionuar edhe Gjykata në Vushtrri me një rast të trajtuar, ajo e Vitisë po ashtu me një rast të trajtuar e Gjilanit I ka pasur tre raste ku vendimet janë marr komfor ligjit, sikurse që kanë marr vendime kompatible edhe Gjykata në Kamenice me një rast, dhe ajo e Suharekës në dy rastet e trajtuara.

Në gjykatën e Pejës, AKK i ka adresuar gjashtë raste, në tre raste janë shqiptuar sanksione, një rast është pezulluar dhe dy të tjera nuk janë trajtuar fare.

Gjykata në Prizren i ka trajtuar 15 raste, nga to, në katër raste ka shqiptuar sanksione, një është pezulluar kurse në 4 raste ka shqiptuar aktvendime “qortuese”. Tek kjo gjykatë janë shqiptuar aktvendime sanksionuese jo komfor ligjit pasi që në tre raste ato janë më të ulëta se dënimi minimal i përcaktuar me ligj,

Gjykatat në Mitrovicë dhe Gjakovë nuk i kanë trajtuar fare rastet sa janë adresuar, tre në të parën e katër në të dytën.

Përfundimi:

Sanksionimi i zyrtarëve që nuk e kanë përmbushur obligimin ligjor nuk duket të jetë shumë kompatibil me kriteret ligjore.

Në disa raste Gjykatat kanë nxjerr vendime jo komfor ligjit apo nuk i trajtojnë ato fare. Prej 165 rasteve të përcjella në gjykata ato i kanë shqiptuar sanksionet në 97 raste apo (58.78%), në 13 raste kanë shqiptuar dënime me gjobë nën minimumin e përcaktuar me ligj e që është 300 euro,

Sipas rregullave të Agjencisë, të gjitha Aktvendimet janë bërë publike në faqen e internetit të AKK-së.

Nga ana tjetër, ndaj të gjitha vendimeve që nuk janë marr në bazë të ligjit janë ushtruar Ankesa në adresë të organeve më të larta.

Llogaritur në përqindje numri i zyrtarëve që kanë bërë deklarin e pasurisë ka qenë relativisht mirë. Nevojitet një përgjegjësi akoma më e madhe e zyrtarëve të lartë publik, karshi procesit të deklarimit të pasurisë pasi që një pjesë e vogël e tyre nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Ligji i ri parasheh masa më të rrepta ndëshkuese ndaj atyre që nuk e respektojnë atë. Megjithatë është me shumë me rëndësi nëse zyrtarët e lartë publik bëhen të ndërgjegjshëm dhe sillen në frymën e kultivimit të transparencës për sa i përket deklarimit të pasurisë së tyre.